



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br Prot Prot No
DPKI	06-1499/20
Nr. ftaq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	15-07-2020
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.07.2020, mori:

**V E N D I M**

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-06-1107/20, për zyrtaren e lartë znj. Bukurije Zhubi, Drejtor në Qendren Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, për shkak se zyrtarja e lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë znj. Bukurije Zhubi, Drejtor në Qendren Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe njëkohësisht Kryetare në Organizatën joqeveritare "Asociacioni i Mjekësisë Transfuzive të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtaren e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtarja e lartë është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtare e lartë publike, nuk mund të ushtroj edhe funksionin drejtues në organizatë joqeveritare sepse kjo është e ndaluar



me neni 14 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

*1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.*

Zyrtarja e lartë, është deklaruar se nuk ka pasur njohuri për një kufizim të tillë të përcaktuar në Ligj, por, ka premtuar se do të ndërmarr veprime për tu larguar nga funksioni drejtues në organizatën joqeveritare Asociacioni i Mjekësisë Transfuzive të Kosovës.

Ndërkohë, zyrtarja e lartë znj. Bukurije Zhubi e ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare me nr. (06-1281-1/20), me të cilën dëshmohet se ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit drejtues në organizatën joqeveritare të lartpërmendur.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

